

NËPËRMJET NUMRAT E BUXHETIT TË RM PËR VITIN 2017


Nga shuma rekorde

3,35 miliard euro

të propozuara para zgjedhjeve në Buxhetin për vitin 2017, madje **1/5, gjegjësisht 698 milion euro**, janë planifikuar të shpenzohen për prokurim të mallrave dhe shërbimeve (shërbime me marrëveshje, materiale dhe inventar i imtë, riparime dhe mirëmbajtje aktuale, shërbime komunale, shpenzime për rrugë dhe ditore, punësime të përkohshme dhe shpenzime tjera aktuale). Prej këtyre **698 milion euro** madje **70% do të shpenzohen për shërbime me marrëveshje.**



- Përfitime sociale
- Rroga
- Mallra dhe shërbime
- Shpenzime kapitale
- Pagesë të pjesës kryesore
- Shpenzime tjera¹



- Shërbime me marrëveshje
- Materiale dhe inventar i imtë + Riparime dhe mirëmbajtje aktuale
- Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport
- Shpenzime për rrugë dhe ditore
- Shpenzime tjera aktuale
- Punësime të përkohshme

Deri sa rritet vdekshmëria nga kanceri i qafës së mitrës dhe rritet vdekshmëria e lehonave dhe të porsalindurve, Ministria e Shëndetit është në rend të parë nga tre institucionet që në vitin 2017 planifikon që shpenzojë më së shumti për pagesën e shërbimeve me marrëveshje, gjegjësisht **pothuaj se 11 milion euro**. Përveç kësaj, për shembull, në Programin për Zbulimin e Hershëm të Sëmundjeve Malinje për vitin 2017 parashikon vetëm **276 mijë euro**. Tek ne, për fat të keq, shëndetësia është më e shtrenjtë, ndërsa shëndeti më i lirë!

INSTITUCIONET MË TË SHTRENJTA PËR KOKË TË PUNËSUAR



Ministria e Shëndetësisë është **institucioni më i shtrenjtë** për kokë të punësuar. Ajo do të thotë që për një të punësuar nga administrata e Ministrisë paguajmë shumë të larta prej **77.545 euro** shpenzime vjetore (operative), ose për të gjithë **215 të punësuar gjithsej 16,7 milion euro**.

Në majë mes institucioneve më të shtrenjta për kokë të punësuar në vitin 2017, me Ministrinë e Shëndetësisë janë edhe Drejtoria për Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale (**54.098 euro shpenzime vjetore për të punësuar**) dhe Agjencia për Investime të Huaja dhe Promovim të Eksportit (**53.781 euro shpenzime vjetore për të punësuar**). Ndonëse qytetarët paguajnë promotorë, investimet e drejtpërdrejta të huaja ulen me shpejtësi. Në vitin 2016 (përfshirë edhe gushtin) investimet e huaja janë vetëm **130,8 milion euro**, ndërsa për krahasim, në vitin 2006 kanë qenë **379,8 milion euro** kur nuk ka ekzistuar kjo Agjenci.²

¹ Në këtë kategori gjendet përmblendja e "rezervave dhe shpenzime të papërcaktuar" dhe "pagesa të interesit"

² Burim: Banka Popullore e RM-së